



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Në bazë të nenit 11,12 dhe nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale me Nr. 03/L-040, Ligjit për Arsim në komunat e Kosovës me Nr. 03/L-068, Udhëzimit administrativ me Nr. 24/2012 të datës 22.10.2012 dhe nenit 5 të Statutit të Komunës Rahovecit me Nr. 569/1, dt. 16. 12. 2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 2 prill 2013, nxjerr këtë:

## **R R E G U L L O R E** **PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTËT E KOMUNËS SË RAHOVECIT**

### **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet, kriteret, kohëzgjatja e realizimit të bursës, lartësia e bursës dhe procedura për ndarjen e bursave për studentët e komunës së Rahovecit, të cilët studiojnë në Universitetet publike të Republikës së Kosovës.

#### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

**Komuna** – është njësi themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale në Kosovë.

**Student** – është çdo person që e ka të regjistruar fakultetin (Universitetin Publik) dhe që i'u është nënshtuar provimeve.

**Bursë** - shuma e caktuar e mjeteve financiare, që i jep komuna një studentit për t'i kryer studimet në një Universitet Publik.

#### **Neni 3**

Komuna e Rahovecit, varësisht prej mjeteve financiare që ka në dispozicion, ndan bursa për studentët e komunës së Rahovecit.

#### **Neni 4**

4.1. Të gjithë studentët e rregullt të komunës së Rahovecit, pa dallime etnike, gjinore, racore, fetare dhe politike, që janë të regjistruar në ndonjë fakultet të Universiteteve publike të Republikës së Kosovës, në përjashtim të studimeve master dhe studimeve post-diplomike, kanë të drejtë të aplikojnë për ndarjen e bursave.

4.2. Përparësi në fitimin e së drejtës në bursë do të kenë studentët që studiojnë në lëmi deficitare.

4.3. Drejtimet deficitare i përcakton Drejtoria e Arsimit.

### **Neni 5**

Kuvendi i Komunës me propozimin e kryetarit të Komunës, merr vendim për numrin e bursave që do të ndahen për studentët të cilët studiojnë në Universitetet publike të Republikës së Kosovës, si dhe shumën financiare për një bursë, që ndahet për një vit akademik (një tetor – tridhjetë e një korrik).

### **Formimi i Komisionit për ndarjen e bursave**

#### **Neni 6**

6.1. Bursat për studentët do të ndahen nga Komisioni i formuar me Vendim Kuvendit të Komunës.

6.2. Komisioni për ndarjen e bursave përbëhet prej 5 anëtarëve.

- a) Tre anëtar të propozuar nga Kuvendi Komunal,
- b) Një anëtar i propozuar nga Kryetari i Komunës,
- c) Një anëtar do të jetë nga shoqëria civile të cilin e propozon Kuvendi i Komunës.

#### **Neni 7**

7.1. Drejtoria për Arsim do të shpall konkursin për ndarjen e bursave. Konkursi duhet të jetë i shpallur në mjetet e informimit, përkatësisht në gazetë ditore, në webfaqen zyrtare të Komunës, në tabelën e shpalljeve, së paku për 30 ditë.

7.2. Në konkurs do të përcaktohet dokumentacioni i kërkuar dhe informatat e tjera të nevojshme.

### **Kushtet dhe kriteret**

#### **Neni 8**

8.1. Obligohet Drejtoria për Arsim, që të kryejë punët teknike-administrative të domosdoshme që rrjedhin nga natyra e punës së Komisionit si dhe punët rreth shpalljes së konkursit dhe formulimit të kontratave dhe të punëve të tjera të ngjashme.

8.2. Të gjitha aplikacionet dhe dokumentet e bashkëngjitura, zyrtari i arsimit obligohet që t'i shikojë dhe vërtetojë nëse janë origjinale.

8.3. Zyrtari i arsimit obligohet që indeksin origjinal ta kopjojë vet, për shkak të përjashtimit të mundësisë për keqpërdorim të indekseve dhe ID kartelave.

8.4. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten edhe këto dokumente:

- a. certifikatën e provimeve së bashku me kopjen e indeksit ose ID kartelën,
- b. certifikatën e vendbanimit,
- c. deklaratën e bashkësisë familjare,

- d. dëshminë që është invalid i luftës, është fëmijë i dëshmorit, është person me aftësi të kufizuar dhe se është student/te nga familja në skemën sociale,
- e. diplomat, mirënjohjet, certifikatat për suksesin e arritur në garat-konkurset kombëtare dhe mbarë kombëtare në lëmin arsimor,
- f. Të gjithë studentët e kategorive të cekura në **nënparagrafin d** të këtij neni obligohen që të sjellin dëshmitë nga shoqatat dhe institucionet përkatëse, por komisioni ruan të drejtën të hulumtojë dhe të vërtetojë vërtetësinë e dokumenteve,
- g. Të kenë të regjistruar vitin akademik për të cilin jepet bursa,
- h. Të mos jenë shfrytëzues të ndonjë burse tjetër (përveç bursës universitare).

## **Kushtet dhe prioritetet**

### **Neni 9**

9.1. Fëmijëve të dëshmorëve të cilët janë studentë, do t'ju ndahet bursa, jashtë kriterëve të përcaktuar më këtë rregullore, ndërsa të tjerët do t'ju nënshtrohen këtyre kriterëve si më poshtë;

9.2. Për suksesin e arritur në mësim në vitin paraprak studenti fiton këto pikë:

9.2.1. Nota mesatare mbi **9 (nëntë)** në fakultet, vlerësohet me **30 pikë**,

9.2.2. Nota mesatare mbi **8 (tetë)** në fakultet, vlerësohet me **20 pikë**,

9.2.3. Nota mesatare **7 (shtatë)** në fakultet, vlerësohet me **15 pikë**,

9.2.4. Për lëminë deficitare që studion kandidati/ja fiton **20 pikë**,

9.2.5. Për kandidatët që kanë **2 (dy)** e më tepër studentë nga e njëjta familje, vlerësohen **15 pikë**,

9.2.6. Personat me aftësi të kufizuar, vlerësohen me **15 pikë**,

9.2.7. Gjendja ekonomike-financiare (rastet sociale), vlerësohen me **20 pikë**,

9.2.8. Fëmijët pa prind vlerësohen me **20 pikë**.

9.3. Në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë nen do të kenë përparësi studentët e familjeve, të viktimave civile të luftës, invalidëve dhe veteranëve të luftës dhe të gjinisë femërore me gjendje të rendë ekonomike.

## **Vlerësimi i kushteve dhe kriterëve**

### **Neni 10**

Pas skadimit të afatit të konkurrimit, komisioni është i obliguar që të takohet, dhe në afat prej 3 ditësh të bëjë vlerësimin e kërkesave. Komisioni gjatë procedurës së vlerësimit të kërkesave do të përcaktojë vetë metodën e punës dhe mënyrën e seleksionimit të kërkesave, gjithnjë duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

### **Neni 11**

11.1. Pas përfundimit të procedurës së seleksionimit, komisioni do të hartojë listën përfundimtare të kandidatëve përfitues të bursës.

11.2. Lista përfundimtare e përfituesve do të shpallet publikisht dhe do të vendoset në tabelën e shpalljeve pranë Drejtorisë së Arsimit, në hyrje të Komunës dhe në webfaqen e Komunës.

11.3 Studentët që janë përfitues të bursës, në bazë të listës përfundimtare janë të obliguar që të lajmërohen në Drejtorinë e Arsimit dhe t'i sjellin:

- a) kopjen e letërnjoftimit,
- b) kopjen e kartelës bankare,
- c) numrin e telefonit kontaktues,
- d) e-mail adresën

11.3 Shfrytëzuesit e bursave e humbin të drejtën e shfrytëzimit nëse në afat të caktuar nuk dëshmojnë me vërtetimin për regjistrimin e semestrit.

## **Formimi i Komisionit për ankesa**

### **Neni 12**

12.1. Komisioni për ankesa përbëhet prej 5 anëtarëve:

- a) Dy anëtar i propozon Kuvendi Komunal,
- b) Dy anëtar i propozon Kryetari i Komunës,
- c) Një anëtar duhet të jetë nga shoqëria civile i cili përzgjidhet nga Kuvendi i Komunës.

12.2. Anëtarët e komisionit për ankesa nuk mund të jenë njëkohësisht në komisionin për ndarjen e bursave.

12.3. Kundër listës përfundimtare të përfituesve të bursave nga komisioni për ndarjen e bursave, lejohet ankesa e cila i drejtohet komisionit të ankesave, i formuar ad-hoc me vendim të Kuvendit të Komunës.

12.4. Ankesa parashtrohet në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljes së listës së përfituesve të bursave nga ana e Komisionit.

12.5. Komisioni për shqyrtimin e ankesave në afat prej 30 ditësh, duhet t'i kthejë përgjigje me shkrim parashtruesit të ankesës.

### **Neni 13**

13.1. Me studentët që fitojnë bursën, do të lidhet kontrata dhe të nënshkruhet nga përfituesi i bursës dhe Kryetari i Komunës.

13.2. Nëse brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e njoftimit të kandidatit, përfitues të bursës, nuk nënshkruhet kontrata nga ana e studentit, konsiderohet se ka hequr dorë nga bursa, përfitues do të jetë kandidati i cili është në listë sipas radhës.

13.3. Me kontratë do të përcaktohet kohëzgjatja dhe shuma për të cilën jepet bursa, obligimet e përfituesit të bursës dhe kushtet tjera.

13.4. Kandidatët të cilët janë shfrytëzues të bursës obligohen që të sjellin certifikatën e notave dhe vërtetimin se nuk është shfrytëzues i ndonjë burse tjetër.

### **Procedura e pagesës**

#### **Neni 14**

14.1. Mjetet financiare do të alokohen me 1 (një) ose 2 (dy) periudha të caktuara gjatë vitit fiskal në xhirrollogaritë bankare të përfituesve, pranë ndonjë banke komerciale të cilën janë të obliguar që studentët ta hapin.

14.2. Drejtoria për Financa dhe Buxhet dhe Drejtoria për Arsim, janë të obliguara të kujdesen për alokimin dhe zotimin e mjeteve të cekura me lartë në afatin kohor.

### **DISPOZIATA KALIMTARE-PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 15**

Për implementimin (zbatimin) e kësaj Rregulloreje do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria për Financa dhe Buxhet.

#### **Neni 16**

Kjo rregullore mund të ndryshohet me procedurë të njëjtë me atë të miratimit.

#### **Neni 17**

Kjo rregullore hyn në fuqi tetë (8) ditë pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Komunës.

01 Nr. \_\_\_\_  
Rahovec, 2 prill 2013

**Kuvendi i Komunës së Rahovecit**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Xhemali Haxhimustafa**